

20071331755

L I G J
PËR TREGTI ELEKTRONIKE
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Lënga e rregullimit

Me këtë ligj rregullohen shërbimet e shoqërisë informative të lidhura me tregtinë elektronike, përgjegjësitë e dhënësve të shërbimeve të shoqërisë informative, komunikimin komercial dhe rregullat lidhur me lidhjen e marrëveshjeve në formë elektronike.

Neni 2

Zbatimi i ligjit

Dispozitat e këtij ligj nuk zbatohen në:

- tatimin,
- mbrojtjen e të dhënave personale,
- veprimtarinë noteriale ose profesione të ngjashme që përfshijnë lidhje të drejtpërdrejt ose të veçantë ndërmjet shfrytëzuesit dhe organit përkatës kompetent të administratës shtetërore,
- përfaqësimin e shfrytëzuesit dhe mbrojtjen e interesave të tij në gjykatë, dhe
- lojërat e fatit me depozitim me para, duke përfshirë edhe lotaritë dhe transaksionet për baste në pajtim me dispozitat nga rregullat të cilat e rregullojnë këtë sferë.

Neni 3

Definicione

Shprehje të caktuara të përdorura në këtë ligj e kanë kuptimin si vijon:

1. "Shërbime të shoqërisë informative" janë shërbimet të cilat sigurohen për kompensimin e largësisë, nëpërmjet mjeteve elektronike dhe me kërkesën personale të pranuesit të shërbimit. "Në largësi" shënon se shërbimi sigurohet pa praninë e të dy anëve në të njëjtën kohë. "Nëpërmjet mjeteve elektronike" do të thotë se shërbimi dërgohet nga pika fillestare/burimore dhe merret në destinacionin e fundit nëpërmjet pajisjes elektronike për procesim (duke përfshirë edhe kompresionin digjital) dhe ruajtjen e të dhënave dhe dërgohet, transmetohet dhe merret në tërësi nëpërmjet kablllos, radio-valëve, mjeteve optike ose mjeteve tjera elektromagnetike. "Me kërkesën personale të pranuesit të shërbimit" do të thotë se shërbimet sigurohen nëpërmjet transmetimit të të dhënave me kërkesë personale. Shërbimet e shoqërisë informative përmbajnë veçanërisht shitjen e prodhimeve dhe të shërbimeve, të shërbimeve për qasje të informatat ose shpallje nëpërmjet Internetit dhe qasje të shërbimit e rrjetit publik komunikues, transmetimin e të dhënave ose ruajtjen e të dhënave të pranuesit në rrjetin publik komunikues.

2. "Dhënës i shërbimeve" është çdo person fizik ose juridik i cili jep shërbime të shoqërisë informative përmes themelimit të shoqërisë tregtare në kohë të pacaktuar në Republikën e Maqedonisë, me ç'rast prania dhe përdorimi i mjeteve teknike dhe teknologjive të nevojshme për dhënien e shërbimit të shoqërisë informative, vetvetiu nuk paraqesin themelimin e dhënësit të shërbimit,

3. "Pranues i shërbimeve" është çdo person fizik ose juridik i cili për shkaqe profesionale ose të tjera shfrytëzon shërbimet e shoqërisë informative, me qëllim që të kërkojë informacion ose të njëjtin ta bëjë të kapshme,

4. "Konsumues" është çdo person fizik i cili i shfrytëzon shërbime të shoqërisë informative për qëllime jashtë veprimtarisë së tij tregtare ose profesionit,

5. "Profesione të rregulluara" janë ato profesione përkatësisht veprimtari profesionale për të cilat kushtet për kryerje janë përcaktuar me ligj,

6. "Nënshkrim elektronik" janë një sërë të dhënash në formë elektronike të cilat përmbahen ose janë të lidhura logjikisht me të dhëna tjera në formë elektronike dhe është i dedikuar për përcaktimin e autenticitetit të të dhënave dhe për përcaktimin e identitetit të nënshkruesit,

7. "Komunikim komercial" është forma e komunikimit e krijuar me qëllim që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të promovojë prodhime, shërbime ose reputacion të shoqërisë tregtare ose të personit i cili kryen veprimtari tregtare ose artizanale. Vijuesja vetvetiu nuk paraqet komunikim komercial:

- kumtimin e informatave që mundësojnë qasje të drejtpërdrejtë te veprimtaria e personit fizik ose juridik, veçanërisht në lidhje me emrin, adresën dhe adresën e postës elektronike,

- komunikimet në lidhje me prodhimet, shërbimet ose reputacionin e personit fizik ose juridik të kryera në mënyrë tjetër e jo në mënyrë elektronike, dhe

8. "Marrëveshje në formë elektronike" janë marrëveshje të cilat personat juridikë ose fizikë tërësisht ose pjesërisht i lidhin, dërgojnë, pranojnë, prishin, heqin dorë, u qasen atyre dhe i tregojnë në formë elektronike, duke përdorur mjete elektronike, optike ose të ngjashme, duke u përfshirë por jo edhe duke u përkufizuar në bartjen nëpërmjet internetit.

Neni 4

Dhënia e shërbimeve të shoqërisë informative

(1) Dhënia e shërbimeve të shoqërisë informative është e lirë.

(2) Dhënësi i shërbimeve të shoqërisë informative në Republikën e Maqedonisë është i detyruar të veprojë dhe të japë shërbime në pajtueshmëri me ligjet dhe dispozitat tjera të Republikës së Maqedonisë.

Neni 5

Përfshirjet nga zbatimi

(1) Dispozita nga neni 4 paragrafi (2) të këtij ligji nuk zbatohet ndaj dhënësit të shërbimeve të shoqërisë informative me seli në vendin anëtar të Unionit Evropian, madje edhe në rastet kur shërbimi u është drejtuar qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

(2) Dispozitat nga neni 4 paragrafi (1) të këtij ligji dhe nga paragrafi (1) të këtij neni nuk zbatohen në këto lëmenj:

- të drejtën autoriale dhe të drejtat nga pronësia industriale,
- emisionin e parave elektronike,
- aktivitetet e shoqërisë së sigurimit,
- lirisë së palëve ta zgjedhin të drejtën e shtetit e cila do të zbatohet për marrëveshjen e tyre,
- përgjegjësitë të cilat dalin nga marrëveshjet për konsum dhe në lidhje me to,
- vlefshmërinë e marrëveshjeve me të cilat krijohen ose barten të drejtat e pronësisë së patundshme, dhe
- lejueshmërinë e komunikimit komercial të pa kërkuar nëpërmjet postës elektronike.

Neni 6

Principi që përjashton autorizimin paraprak

Për dhënien e shërbimeve shoqërisë informative nuk është e nevojshme leje, pëlqim ose koncesion i veçantë.

II. INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI KOMERCIAL

Neni 7

Informacionet të cilat duhet të sigurohen

(1) Dhënësi i shërbimeve të shoqërisë informative pranuesit të shërbimeve dhe organeve kompetente të administratës shtetërore në Republikën e Maqedonisë është i detyruar t'i bëjë të kapshme lehtë, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të përhershme së paku këto informacione:

- emrin përkatësisht firmën e dhënësit të shërbimit,

- selinë e personit juridik, dhënës i shërbimit ose adresën nëse është person fizik,
- të dhënat për dhënësin e shërbimit në bazë të së cilave pranuesi i shërbimit drejtpërdrejt dhe në mënyrë efikase mund të vihet në kontakt me të, duke përfshirë adresën elektronike,
- aktvendimin me të cilin dhënësi i shërbimeve të shoqërisë informative është i regjistruar në regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë,
- të dhënat nga organi kompetent, nëse dhënësi i shërbimit i nënshtrohet detyrimit për lëshimin e licencave ose llojit tjetër të lejeve, dhe
- numrin tatimor nëse dhënësi i shërbimit është debitor i TVSH.

(2) Përveç informatave nga paragrafi 1 të këtij neni, dhënësi i shërbimeve të shoqërisë informative i cili kryen profesion të rregullt është i detyruar t'i bëjë të jenë të kapshme edhe këto informacione:

- të dhënat për institucionin tek i cili është i regjistruar dhënësi i shërbimit,
- emërtimin profesional dhe vendin në të cilin është marrë ai emërtim, dhe
- dedikimin e rregullave profesionale në vendin ku e ushtron veprimtarinë dhe mënyrën e qasjes tek ato.

(3) Nëse dhënësi i shërbimeve të shoqërisë informative i thekson çmimet e prodhimeve dhe shërbimeve, ato doemos duhet të theksohen qartë dhe pa hamendje, veçanërisht duhet të theksohet nëse vallë në to janë përfshirë shpenzimet e dërgesës, tatimet dhe shpenzimet manipuluese të cilat kanë ndikim në çmimin e theksuar.

Neni 8

Komunikimi komercial

Dhënësi i shërbimeve është i detyruar të sigurojë se të dhënat nga komunikacioni komercial i cili është pjesë e shërbimeve të shoqërisë informative ose e përbëjë të njëjtën, janë në pajtim së paku me këto kushte:

- komunikimi komercial të mund të identifikohet qartë si i tillë në momentin kur shfrytëzuesi do ta pranojë,
- të mund të identifikohet qartë personi fizik ose juridik në emër të të cilit bëhet komunikimi komercial, dhe
- çdo ofertë promovuese nga komunikimi komercial (duke përfshirë zbritjet dhe dhuratat), mund të identifikohet qartë si e tillë dhe kushtet të cilat duhen të plotësohen për dhënien e ofertës nga komunikimi komercial të jenë të kapshme lehtë dhe qartë dhe të paraqitura pa mëdyshje.

Neni 9

Komunikimi komercial i pa kërkuar

Shfrytëzimi i postës elektronike me qëllim të dërgimit të komunikimit komercial të pa kërkuar lejohet vetëm me pranimin paraprak nga ana e shfrytëzuesit të cilit ai lloj i komunikimit i është drejtuar, në pajtueshmëri me Ligjin për komunikimet elektronike.

III. MARRËVESHJET E LIDHURA NË FORMË ELEKTRONIKE

Neni 10

Forma dhe vlefshmëria e marrëveshjeve në formë elektronike

- (1) Marrëveshjet mund të lidhen nëpërmjet elektronikës, përkatësisht në formë elektronike.
- (2) Oferta dhe pranimi i ofertës mund të lëshohet nëpërmjet elektronikës, përkatësisht në formë elektronike.
- (3) Marrëveshjes së lidhur në formë elektronike nuk do t'i kontestohet plotfuqishmëria për shkak se është bërë me dërgesë elektronike, përkatësisht në formë elektronike.
- (4) Kur për plotfuqishmërinë dhe lidhjen e marrëveshjes është i nevojshëm nënshkrim i personit, do të llogaritet se ai kusht është plotësuar me dërgesë elektronike të nënshkruar me nënshkrim elektronik në pajtueshmëri me dispozitat për nënshkrim elektronik.

- (5) Dispozitat nga paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni nuk zbatohen në marrëveshjet:
- të rregulluara me dispozitat për familjen dhe për trashëgimin,
 - të cilat krijojnë ose bartin të drejta të pronës së patundshme, me përjashtim të së drejtës për qiramarrje,
 - për të cilat në bazë të ligjit ka nevojë për përfshirjen e gjykatave, noterëve ose profesioneve të ngjashme, dhe
 - për garancinë e dhënë dhe për sigurimin plotësues, nga ana e personave që veprojnë për qëllime jashtë angazhimit të tyre tregtar, të punës ose profesional.

Neni 11

Zbatimi shtesë i dispozitave

Nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe, ndaj marrëdhënieve me marrëveshje juridike të cilat dalin ose janë të lidhura me marrëveshjet e lidhura nëpërmjet elektronikës ose në formë elektronike, zbatohen dispozitat nga Ligji për marrëdhënie obligative.

Neni 12

Informacionet të cilët duhet të sigurohen për lidhjen e marrëveshjes

(1) Dhënësi i shërbimit të shoqërisë informative është i detyruar që pranuesit të shërbimit para lidhjes së marrëveshjes, në mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe pa hamendje t'i sigurojë informacionet si vijon:

- procedura të ndryshme teknike që duhen të përcillen që të lidhet marrëveshja,
- përmbajtja e marrëveshjes,
- kushtet e përgjithshme të punës nëse janë pjesë përbërëse e marrëveshjes,
- nëse marrëveshjen e lidhur dhënësi i shërbimeve do të arkivojnë dhe nëse e njëjta do të jetë e kapshme,
- mjetet teknike për identifikimin dhe rregullimin e të dhënave të futura gabimisht para së të bëhet porosia, dhe
- gjuhët e ofruara për lidhjen e marrëveshjes.

(2) Dhënësi i shërbimit doemos duhet t'i theksojë të gjitha kodekset relevante të praktikës së mirë në të cilën është nënshkruar dhe informacionet për atë se si ato kodekse mund të shfrytëzohen në formë elektronike.

(3) Dispozitat e përmbajtura në marrëveshjet në formë elektronike që i lidhin dhënësit e shërbimeve të shoqërisë informative, doemos duhet të jenë të vendosura nga ana e dhënësve në dispozicion të shfrytëzuesve të shërbimeve në mënyrë e cila mundëson magazinimin dhe reproduksionin e të njëjtëve.

(4) Palët kontraktuese të cilat nuk janë konsumatorë në marrëdhëniet reciproke të kontraktuara mund të kontraktajnë heqje dorë nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

(5) Dispozitat nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni nuk kanë të bëjnë me marrëveshjet e lidhura përmes postës elektronike ose në formë përkatëse të komunikimit personal me të.

Neni 13

Porosia dhe vërtetimi për pranimin e porosisë

(1) Pranuesi i shërbimit kur bën porosi në formë elektronike është i detyruar të kërkojë nga dhënësi i shërbimit t'i parashtrijë vërtetim për pranimin e porosisë pranuesit me porosi të veçantë elektronike pa prolongim dhe në formë elektronike.

(2) Dhënësi i shërbimeve i vë në dispozicion pranuesit të shërbimeve mjete teknike përkatëse, efikase dhe të kapshme me të cilat i mundësohet t'i njohë dhe t'i përmirësojë të dhënat e futura gabimisht para se ta bëjë porosinë, përveç në rast kur palët që nuk janë konsumatorë nuk merren vesh ndryshe.

(3) Porosia dhe vërtetimi për pranim llogariten si të pranuar kur të njëjtat janë të kapshme për palët të cilave u janë adresuar.

(4) Dispozitat nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni nuk kanë të bëjnë me marrëveshjet e lidhura ekskluzivisht përmes shkëmbimit të postës elektronike ose në formë përkatëse të komunikimit personal me të.

Neni 14

Lidhja e marrëveshjes

(1) Marrëveshja në formë elektronike llogaritet e lidhur në atë moment kur ofertuesi do ta pranojë porosinë elektronike e cila përmban deklaratën e pranuesit se e pranon përmbajtjen e ofertës.

(2) Oferta dhe pranimi i ofertës llogariten të pranuar kur të njëjtat janë të kapshme për palëve të cilave u janë adresuar.

IV. PËRGJEGJËSIA E PRANUESIT DHE E DHËNËSIT TË SHËRBIMEVE TË SHOQËRISË INFORMATIVE

Neni 15

Dispozitat e përbashkëta

(1) Kur jepen shërbime të shoqërisë informative, e përbëhen nga bartja e informacioneve të dhëna nga pranuesi i shërbimeve nëpërmjet rrjetit komunikues ose nga sigurimi i qasjes te rrjeti komunikues, dhënësi i shërbimit nuk përgjigjet për informacionin e bartur, me kusht që dhënësi:

- të mos e iniciojë bartjen,
- të mos e zgjedhë pranuesin e bartjes, dhe
- të mos e zgjedhë ose të mos e ndryshojë informacionin të përmbajtur në bartje.

(2) Vetë bartja dhe sigurimi i qasjes së theksuar në dispozitën nga paragrafi 1 të këtij neni përfshin magazinim automatik, ndërmjetësuese dhe kalimtar të informacionit të bartur nëse kjo bëhet me qëllim të vetëm që të bëhet bartja përmes rrjetit komunikues dhe me kusht që informacioni të mos jetë i magazinuar më gjatë se sa është e nevojshme për bartjen e të njëjtës.

Neni 16

Magazinimi automatik, ndërmjetësues dhe i përkohshëm

Dhënësi i shërbimit kur jep shërbime të shoqërisë informative të cilat përbëhen nga bartja e informacioneve të dhëna nga pranuesi i shërbimeve përmes rrjetit komunikues, nuk përgjigjet për magazinimin automatik, ndërmjetësues dhe të përkohshëm të atij informacioni të nxjerrë me qëllim të vetëm për bartje më efikase të mëtutjeshme të informacionit të pranues të tjerë të informacionit dhe pranues të tjerë të informacionit, me kërkesë të tyre, me kusht që:

- dhënësi të mos e ndryshojë informacionin,
- dhënësi t'i plotësojë kushtet për qasje te informacioni,
- dhënësi t'i respektojë rregullat që kanë të bëjnë me azhurnimin e informacionit,
- dhënësi të mos e pengojë përdorimin ligjor të teknologjisë e cila përdoret me qëllim që të marrë të dhënë për përdorimin e informacionit, dhe
- dhënësi të veprojë shpejt për shkak të mënjanimit ose pamundësimin të qasjes te informacioni që e ka magazinuar prej kur do të zbulojë se informacioni gjatë burimit të tij parësor të bartjes është hequr nga rrjeti ose është pamundësuar qasja te ai, ose gjykata ose organi tjetër kompetent e ka urdhëruar atë largim ose pamundësim.

Neni 17

Magazinimi

(1) Dhënësi i shërbimit të shoqërisë informative, i cili i magazinon të dhënat nga ana e pranuesit të shërbimit, nuk përgjigjet për përmbajtjen e të dhënave të magazinuar me kërkesën e pranuesit të shërbimit, me kusht që:

- dhënësi të mos dijë për aktivitetin jolegal ose të dhënë,
- të mos jetë i vetëdijshëm për faktet ose për rrethanat nën të cilat është vërejtur aktiviteti jolegal ose e dhëna, ose
- dhënësi menjëherë pasi të zbulojë të veprojë shpejt me qëllim që ta mënjanojë ose pamundësojë qasjen te informatat.

(2) Dispozita nga paragrafi 1 i këtij neni nuk zbatohet kur pranuesi i shërbimeve vepron ndaj autorizimeve të dhënësit të shërbimeve ose dhënësi dhe pranuesi paraqesin shoqëri të lidhura.

Neni 18

Lidhjet

Dhënësi i shërbimeve i cili përmes udhëtimit elektronik hap qasje te të dhëna tjera nuk është përgjegjës për ato informacione, nëse:

- nuk ka njohuri e as që ka mundur të dijë për aktivitetet jolegale të pranuesit të shërbimit ose për përmbajtjen e të dhënave në ato informacione,
- menjëherë sapo të zbulojë se bëhet fjalë për aktivitete jolegale ose të dhëna i mënjanojë ose pamundësojë qasjen te të njëjtat.

Neni 19

Mbrojta e të drejtës

Edhe përkundër dispozitave nga nenet 14, 15, 16 dhe 17 të këtij ligji, gjykatat dhe organet tjera kompetente dhe institucionet në Republikën e Maqedonisë në pajtim me ligjet e Republikës së Maqedonisë, me kërkesën e personave të autorizuar, u urdhërojnë dhënësve të shërbimeve të shoqërisë informative dhe pranuesve të tyre ta mënjanojnë dhe pengojnë cenimin e dispozitave ekzistuese dhe në bazë të tyre të ndërmarrin edhe masa tjera në pajtim me ligjin.

Neni 20

Detyrimet e dhënësit të shërbimeve të shoqërisë informative

(1) Dhënësi i shërbimeve gjatë zëdhënies së shërbimeve të shoqërisë informative nuk është i detyruar t'i kontrollojë të dhënat të cilat i ka magazinuar, bartur ose i ka bërë të kapshme, përkatësisht t'i hulumtojë rrethanat të cilat çojnë në aktivitete jolegale pranuesit të shërbimeve.

(2) Dhënësi i shërbimeve të shoqërisë informative është i detyruar t'i informojë organet kompetente të administratës shtetërore nëse vërteton:

- se ekziston dyshim i bazuar se pranuesi i shërbimit gjatë përdorimit të shërbimeve të veta të ndërmarrë aktivitete të palejueshme, dhe
- se ekziston dyshim i bazuar pranuesi i shërbimeve të tija të jep të dhëna të paligjshme.

(3) Dhënësi i shërbimeve të shoqërisë informative është i detyruar që në afat më të vogël të mundshëm t'u paraqesë organeve kompetente të administratës shtetërore me kërkesën e tyre, informacione që mundësojnë identifikimin e pranuesve të shërbimeve të tyre me të cilat kanë marrëveshje për magazinim.

V. MBIKËQYRJA DHE MBIKËQYRJA INSPEKTUESE

Neni 21

Mbikëqyrja dhe mbikëqyrja inspektuese

(1) Mbikëqyrje mbi zbatimin e këtij ligji bëjnë Ministria e Ekonomisë, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve dhe Agjencia për komunikime elektronike në pajtim me kompetencat e tyre të përcaktuara me ligj.

(2) Mbikëqyrje inspektuese mbi zbatimin e këtij ligji bëjnë Inspektorati shtetëror i tregut dhe Agjencia për komunikime elektronike.

(3) Për shkak të zbatimit të mbikëqyrjes inspektuese, dhënësit e shërbimeve të shoqërisë informative janë të detyruar që inspektorëve t'u mundësojnë qasje te pajisja elektronike dhe aparatet dhe pa prolongim të paraqesin informacione të nevojshme dhe dokumentacion në lidhje me lëndën e mbikëqyrjen inspektuese.

VI. DISPOZITAT PËR KUNDËRVAJTJE DHE ZGJIDHJA JASHTËGJYQËSORE E KONTESTEVE - ARBITRAZHI

Neni 22

Dispozitat për kundërvajtje

(1) Me gjobë në shumë prej 5 000 deri në 8 000 euro me kundërvlerë në denarë në ditën e pagesës, do t'i kumtohet dënim personit juridik dhënës i shërbimeve të shoqërisë informative për kundërvajtjen, nëse:

- 1) nuk i siguron informacionet nga neni 7 i këtij ligji,
- 2) nuk siguron pajtueshmëri të të dhënave me kushtet e përcaktuara në nenin 8 të këtij ligji,
- 3) pranuesit të shërbimit para lidhjes së marrëveshjes nuk i siguron informacionet e përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 12 të këtij ligji,
- 4) nuk siguron qasje te dispozitat e përmbajtura në marrëveshjen në formë elektronike në mënyrë e cila do të mundësojë magazinimin dhe reproduktimin e të njëjtëve të përcaktuar me paragrafin 3 të nenit 12 të këtij ligji,
- 5) nuk i kryen detyrimet e përcaktuara me paragrafin 2 dhe 3 të nenit 20 nga ky ligj, dhe
- 6) nuk mundëson qasje te pajisja elektronike dhe aparatet dhe pa prolongim nuk paraqet të dhëna të nevojshme dhe dokumentacion për kryerjen e mbikëqyrjes së inspektimit në pajtim me paragrafin 5 të nenit 21 të këtij ligji.

(2) Me gjobë në shumë prej 1 000 deri në 3 000 euro, me kundërvlerë në denarë, në ditën e pagesës, për kundërvajtjet nga paragrafi 1 do t'i kumtohet dënim personit përgjegjës në personin juridik dhënës i shërbimeve të shoqërisë informative.

(3) Me gjobë në shumë prej 1 000 deri në 2 000 euro, me kundërvlerë në denarë, për kundërvajtjet nga paragrafi 1 të këtij neni do t'i kumtohet dënim personit fizik dhënës i shërbimeve të shoqërisë informative.

(4) Personit juridik - dhënës i shërbimeve të shoqërisë informative, gjykata kompetente, përveç gjobës do t'i kumtojë edhe sanksion për kundërvajtje ndalesë e përkohshme të kryerjes së veprimtarisë dhënie të shërbimeve të shoqërisë informative në kohëzgjatje prej një deri në pesë vjet, ndërsa personit përgjegjës në personin juridik - dhënës i shërbimit të shoqërisë informative, organi kompetent do t'i kumtojë edhe sanksion për kundërvajtje - ndalesë për kryerjen e detyrimit në kohëzgjatje nga një deri në pesë vjet.

Neni 23

Zgjidhja jashtëgjyqësore e kontesteve - arbitrazhi

(1) Dhënësi i shërbimeve shoqërisë informative dhe pranuesi i shërbimeve për zgjidhjen e kontesteve në mes tyre mund të kontraktjnë kompetencë arbitrazhi.

(2) Për procedurën para arbitrazhit ose me organ tjetër për zgjidhje jashtëgjyqësore të kontesteve zbatohen dispozitat me të cilat rregullohen këto sfera.

VII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 24

Dispozitat kalimtare

Dispozita nga neni 5 paragrafi (1) i këtij ligji do të zbatohet me ditën e aderimit të Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropian.

Neni 25

Dispozita përfundimtare

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.